



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM

Datë 10.06.2021

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 5 pika 3 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall sot thirrjen për fillimin e procedurave për plotësimin e pozicioneve vakante në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit, përmes procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele si më poshtë:

1. Pozicion vakant Prokuroria pranë Shkallës së parë Berat
2. Pozicion vakant Prokuroria pranë Shkallës së parë Berat
3. Pozicion vakant Prokuroria pranë Shkallës së parë Lezhë
4. Pozicion vakant Prokuroria pranë Shkallës së parë Gjirokastrë
5. Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Dibër
6. Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Kukës
7. Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tropojë
8. Pozicion vakant Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë

Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë janë :

- a) prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- b) prokurorët e komanduar;
- c) prokurorët në skemë delegimi.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë i’u bën thirrje që të kandidojnë të gjithë prokurorëve që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të mos ketë qenë anëtar i Këshillit në tri vitet e fundit;
- ç) të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës gjatë 5 viteve të fundit, përveç rastit të parashikuar nga neni 40, pika 2, germa “b” e ligjit për statusin.

Kandidatët që plotësojnë kushtet e sipërpërmendura i paraqesin kërkesat e tyre jo më vonë se data 24.06.2021

Krahas kërkesës për kandidim, kandidatët dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesa për shprehjen e interesit ku renditen deri në tre pozicione sipas radhës së preferencës, për të kandiduar për pozicionin/et e lira të shpallur;
- b) Një jetëshkrim i përditësuar;
- c) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi;
- ç) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit për Statusin;
- d) Çdo dokument tjetër që e gjykon të arsyeshëm kandidati.

Aplikimet do të dorëzohen në formë elektronike në adresën: karriera@klp.al (në këtë rast të gjitha dokumentat e sipërpërmendura duhet të jenë të skanuara) ose në formë fizike në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, godina e “Polit të Drejtësisë”, Tiranë.